



Inhaltsverzeichnis

	<i>Seite</i>
Herzlich Willkommen	2
<i>Christlicher Glaube</i>	
Was Sie über den christlichen Glauben wissen sollten	4
<i>Leben in Deutschland</i>	
Freiheit und Regeln	6
Vertrauen und Ehrlichkeit	7
Gleichberechtigung und Begrüßung	8
Pünktlichkeit und Termine	9
Mülltrennung in Deutschland	10
Ressourcen schonen	12
Familie als Fundament des Zusammenlebens	14
<i>Feste und Feiertage</i>	
Weihnachten in Deutschland	17
Ostern – ein großes Fest im Jahr	19
Himmelfahrt – Jesus wird in den Himmel aufgenommen	22



Mirë se vini

Mirëdita – ju urojmë paqe dhe gjithë të mirat!

Mirë se erdhët në Gjermani dhe në faqen Deutschlandbegleiter.de. Informacionet, që kemi përmbledhur për ju këtu kanë për qëllim t'ju ndihmojnë që të orientoheni dhe të ambientoheni me jetesën në Gjermani.



©William Perugini, 123rf.de

Ndoshta disa gjëra funksionojnë ndryshe nga se i keni imagjinuar. Në Gjermani jetojnë së bashku njerëz me prejardhje të ndryshme dhe me sisteme të ndryshme vlerash. Gjermania është pra një vend i shumëllojshëm dhe ekzistojnë disa parime të rëndësishme, të cilat duhet ti dini dhe ti mbani parasysh. Gjermania mund të bëhet atdheu juaj i ri. Për të arritur këtë, juve do t'ju duhet me shumë gjasa të ndesheni me disa pengesa zyrtare. Pavarësisht këtyre pengesave ne dëshirojmë t'ju vijmë në ndihmë me këshillat dhe udhëzimet tona me qëllim që të bëheni me sukses një pjesë e shoqërisë gjermane.

Me qëllim që të ndiqni rrugën e mbarë, nga Deutschland-Begleiter.de po ju ftojmë në një udhëtim. Zbuloni Gjermaninë dhe gjermanët me traditat e tyre të jetesës dhe mësoni gjërat që ju ndihmojnë sesi të silleni në jetën e përditshme me njerëzit.

Sjellet e vetëkuptueshme për gjermanët mund të jenë të panjohura për ju

Shumë prej gjërave, që po iu shpjegojmë këtu, janë një pjesë e vetëkuptueshme e edukatës tonë në familje apo shkollë. E thënë ndryshe, i kemi mësuar që me qumështin e nënës. Megjithatë ekzistojnë ndryshime të mëdha, të cilat pjesërisht janë rajonale dhe pjesërisht janë të lidhura me ndryshimet në edukatën individuale të secilit. Ne Deutschlandbegleiter përpiqemi të prekim ato tema që vlejné në përgjithësi për gjithë Gjermaninë dhe që janë të rëndësishme për ju.

Rregullat si bazë e lirisë

Një diçka e rëndësishme që në fillim: Në Gjermani ekzistojnë një serë rregullash, ligjesh dhe formularësh. Disa njerëzve ato iu duken strikte, pa ndienja apo pak njerëzore. Edhe njerëzit që jetojnë prej një kohe të gjatë në Gjermani, kanë në raste të caktuara vështirësi për ti kuptuar të gjitha rregullat. Ne ju rekomandojmë që t'ju përmbaheni rregullave dhe ligjeve dhe të zbuloni qëllimin e tyre sepse kjo do jetë në të mirën tuaj. Pasi edhe nëse këto rregulla tingëllojnë çuditshëm, ato pa përjashtim shërbejnë për t'ju lehtësuar jetesën. Ligjet mundësojnë një liri të madhe dhe një hapësirë të gjerë për të shpalosur aftësitë, cilësitë apo idetë e reja. Për këtë Gjermania është e njohur në mbarë botën. Ato shërbejnë për një rrjedhë kuptimplotë të jetës së përditshme dhe për një bashkëjetesë të mirë edhe me njerëz të ndryshëm që kanë ëndrra, pikësnyime apo qëllime të ndryshme.



©Tim Reckman, pixelio.de



Rrënjët e krishtera të shoqërisë gjermane

Edhe disa fjalë rreth nesh: Në faqen "Deutschlandbegleiter.de" angazhohen të krishterë nga vende dhe kultura të ndryshme, të cilët kanë gjetur shtëpinë e tyre nëpër bashkësi të ndryshme në gjithë Gjermaninë. Ne i kemi mbledhur qëllimisht informacionet, që iu referohen rrënjëve të krishtera të shoqërisë tonë. Gjithkush mund të pëfitojë nga këshillat lidhur me vendin tonë dhe me përfytyrimet tona morale. Nuk është nevoja të jesh i krishterë për këtë. Edhe kjo është pjesë e shoqërisë tonë të hapur.

Kontakti me gjermanët të ndihmon të bëhesh pjesë e shoqërisë

Kur mbërrini këtu në Gjermani, miqtë dhe familja juaj gjenden shumë larg jush. Në fillim nuk është gjithmonë e lehtë për të krijuar marrëdhënie të reja. Ne ju ftojmë që të njihni edhe njerëz, të cilët jo me deomos vijnë nga vendi apo nga zona juaj. Flisni hapur me Gjermanët. Shumë vullnetarë në qendra të ndryshme dhe të krishterë, që iu kanë dhënë këtë material e bëjnë punën e tyre në mënyrë vullnetare. Kjo do të thotë, ata ndihmojnë vullnetarisht dhe pa asnjë lloj pagese – sepse kanë interes tek ju si njerëz. Pjesa më e madhe e Gjermanisë ju konsideron ju si një pasuri për vendin dhe gëzohen t'ju njohin personalisht.



Ndoshta mund t'ju ndodhë të përjetoni, që disa njerëz me të cilët përballeni, të tregohen të ftohtë apo të neverishtëm. Të jeni të sigurt: Kjo nuk ndodh për një arsye të keqe, por është një ndienjë pasigurie nga ana jonë, sesi t'ju ndihmojmë dhe të sillemi sa më mirë me ju. Takimet e suksesshme ndodhin kur të dyja palët i drejtohen njëra-tjetrës.

Ne ju ftojmë të mendoni rreth kësaj që përshkruam, të krijoni marrëdhënie, të mësoni gjermanisht dhe të njihni Gjermaninë. deutschland-begleiter.de ju ndihmon për këtë. Hidhni herë pas here një sy faqes së Deutschlandbegleiter, pasi aty publikojmë rregullisht materiale të reja dhe shtojmë gjuhë të reja.



Çfarë duhet të dini rreth besimit të krishterë

Më shumë se gjysma e gjermanëve ndihen pjesë e një kisha. Kjo tregon, që besimi i krishterë është një themel shumë i rëndësishëm në shoqërinë tonë, edhe pse shumë njerëz nuk e ndajnë më këtë besim. Shumë nga rregullat e bashkëjetesës, që ne si Deutschlandbegleiter i përcjellim tek ju, janë të pasqyruar në Bibël. Prandaj dëshirojmë të ndajmë shkurtimisht me ju një vështrim mbi besimin e krishterë.

Të krishterët besojnë në një Perëndi të vetëm, të dashur dhe të plotfuqishëm, i cili është Krijuesi. Ai ka krijuar kozmosin dhe njeriun sipas shëmbëlltyrës së vet. Për shkak se Perëndia dëshironte një qenie të dashur, ai krijoi njeriun si një krijesë të lirë. Njeriu e ka keqpërdorur këtë liri, për t'ju kundërvënë Perëndisë. Prandaj njeriu është ndarë nga Perëndia. Këtë ndarje të krishterët e quajnë mëkat. Ai shkatërron marrëdhënien me Perëndinë.

Rrugëzgjdhje nga ndarja me Perëndinë

Por për shkak se Krijuesi e do krijesën e Tij, Ai ka dërguar birin e Tij të vetëm në botë, me qëllim që ne të hyjmë sërish në një marrëdhënie me Të dhe të pajtohemi. Simbol për këtë pajtim është kryqi.

Kryqi është simbol për faljen e Perëndisë dhe për dashurinë kërkuese të Tij ndaj nesh. Me anë të Jezusit, të kryqëzuarit (i cili ka sjellë ofertën për pajtim), ne e dimë që Perëndia na do dhe dëshiron të pajtohet me ne.




E ardhmja tek Perëndia është e sigurtë

Të qenit i krishterë do të thotë të besosh në këtë pajtim, ta pranosh atë, të pranosh dhe të pendohesh për mëkatet që ke bërë. Ky besim na jep sigurinë që jemi të shpëtuar dhe që kemi një të ardhme të përjetshme me Perëndinë. Pikërisht këtë gjë na e ka premtuar Perëndia! Ne nuk mundemi dhe nuk duam të kundërshtojmë Perëndinë.

Njerëzit që besojnë kanë një shpresë, që iu heq frikën nga gjyqi. Të krishterët kanë shpresën, që do të shkojnë në parajsë pas vdekjes.



Premtimet e Perëndisë, pohimet e Tij në Bibël, Shkrimi i Shenjtë i të krishterëve janë dhuratat e veçanta të besimit. Baza e besimit të krishterë është Bibla. Ajo përmban Shkrimin e Shenjtë, sepse nga ky shkrim ne kuptojmë se kush është Perëndia. Të krishterët besojnë, që Shkrimi i Shenjtë është frymëzuar nga Perëndia dhe është në unitet me Perëndinë. Shkrimi përbën autoritetin kyç përsa u përket çështjeve të besimit dhe udhëheqjes në jetë. Për shkak se ky libër është shkruajtur nga njerëzit, shpeshherë ndeshim bindjen, se Fjala e Perëndisë mund të jetë falsifikuar. Të krishterët besojnë, se vetë Perëndia është kujdesur që Fjala e Tij të vijë tek njerëzit e pandryshuar apo falsifikuar.



Një Perëndi

Të krishterët besojnë në një Perëndi të vetëm, edhe pse ai ka disa cilësi: Ai është i Plotfuqishëm, Ai është Ati dhe Ai është Dashuri.

Të krishterët pra nuk besojnë në tre Perëndi. Ata besojnë në një Perëndi të vetëm, i cili shfaqet në tre forma, në formën e Atit, Birit dhe të Frymës së Shenjtë. Ky trinitet mund të krahasohet me një kub, që ka disa faqe, por që përbën një njësi të vetme. Nëse keni dëgjuar që Maria është pjesë e trinitetit, atëherë ky informacion është gabim. Të krishterët besojnë, që Perëndia nuk ka kryer marrëdhënie seksuale me të.

Nëse dëshironi të dini me shumë rreth besimit tonë të krishterë, atëherë flisni me të krishterët që jetojnë afër jush. Në faqen deutschlandbegleiter.de ju do të gjeni kisha, ku mund të drejtoheni, ose thjesht mund të pyesni ata persona, të cilët ju kanë folur rreth nesh.



Vështim i përgjithshëm mbi lirinë

Bashkëjetesa njerëzore dhe bazat e saj zhvillohen shpesh duke kaluar shekuj apo mijëvjeçarë. Nën këndvështrimin historik të gjitha vendet e Evropës janë të lidhur ngushtë me njeri-tjetrin, sidomos me anë të rrënjëve të krishtera nga të ashtuquajturit „vendet e Perëndimit“. Një themel i Evropës është besimi në Jezus Krisht që bazohet në Bibël. Edhe pse njerëzit në Evropë dhe në Gjermani nuk e ndajnë më plotësisht besimin në Jezusin, shumë sjellje në jetën e përditshme dhe konventa bazohen në krishtërim.



Një pikë të rëndësishme e përben liria. Jezusi i la njerëzit e tij të zgjidhnin lirisht, nëse dëshironin ta ndiqnin atë apo jo. Liria bazohet në lirinë e njeriut për të marrë vendime para Perëndisë duke u mbështetur në vlerën e pafund, që Perëndia i jep çdo njeriu me anë të dashurisë së Tij. Kushdo që e kupton lirinë në këtë mënyrë, për të çdo njeri gëzon të drejta të barabarta dhe nga i cili gjithkush merr të njëjtin vlerësim.

Në Gjermani shumë nga llojet e lirive janë mishëruar në ligj. Çdokush ka të drejtën të shprehë mendimin e vet, ekziston liria e besimit fetar. Shtypi është i pavarur nga institucionet qeveritare si dhe gjykatat mbështeten vetëm në ligj dhe jo në udhëzimet e njerëzve. Liria personale është shumë e rëndësishme për njerëzit në Gjermani. Gjithkush dëshiron të shpalosë aftësitë e veta individuale dhe kjo gjë i lejohej. Kufijtë vendosen aty, ku sjellja e një njeriu mund të shkaktojë dëme për dikë tjetër.

Vlerësohet ai që respekton rregullat

Në Gjermani shumë nga këto kufij janë të përcaktuar me rregullore. Për shembull ekzistojnë rregullore se deri në ç'orë lejohet të dëgjosh muzikë me zë të lartë në banesë dhe kur jo. Kjo rregullore mundëson lirinë që njeriu të mund të flejë në qetësi për disa orë të caktuara. Kështu për shembull është e zakonshme që në përgjithësi praj orës 22.00 deri në orën 7.00 dhe nga ora 13.00 deri në 15.00 të mos kryhen punë që shkaktojnë zhurmë. Kjo rregullore vlen për gjatë gjithë ditës kur bëhet fjalë për ditën e dielë dhe për ditë pushimi apo feste.



©chalabala, fotolia.de

Edhe nëse kjo fjali tingëllon pak e çuditshme: Ligjet mundësojnë liri, në këtë rast ato mundësojnë lirinë për të mos u shqetësuar nga zhurmat e ndryshme gjatë orëve të caktuara. Për këtë arsye në Gjermani është tradicionalisht e zakonshme që njerëzit t'iu përmbahen rregullave edhe nëse nuk i sheh dikush. Ne si Deutschlandbegleiter ju inkurajojmë të ndiqni rregullat, pasi në Gjermani shihen me sy të mirë kryesisht ata njerëz, të cilët dinë t'iu përmbahen rregulloreve. Edhe pse jo të gjithë e ndjekin në çdo kohë këtë traditë, ata njerëz që zbatojnë rregulloren do të gëzojnë besim dhe respekt.



Besimi dhe ndershmëria

Tema e besimit është shumë e rëndësishme. Si në Evropë ashtu edhe në Gjermani njerëzit duan ti besojnë njëri-tjetrit edhe përtej kufijve të familjes apo fisit. Mund të nevojitet një kohë e gjatë derisa të mund të fitohet ky besim me anë të sjelljes. Kjo gjë vlen edhe në shoqëri. Për këtë arsye është tepër e rëndësishme të tregohesh gjithmonë i sqertë, pasi njerëzit nuk duan të mashtrohen. Madje është më mirë, nëse tregon të vërtetën, edhe nëse mendon se kjo e vërtetë nuk do ti pëlqejë tjetrit. Në këtë mënyrë ju krijoni besim, gjë që është baza për një miqësi apo për çdo marrëdhënie tjetër njerëzore. Në këtë mënyrë ju forconi besnikërinë tuaj si në jetën e përditshme ashtu edhe në biseda të rëndësishme.

Sinqeriteti si shenjë e respektit

Pjesë e ndershmërisë është gjithashtu fakti, që gjermanët thonë ndonjëherë edhe „Jo“. Për shembull në rastin e një ftese. Kjo nuk do të thotë që personi i ftuar duhet pyetur edhe njëherë nëse do ta pranojë ftesën, por nga ana tjetër nuk do të thotë gjithashtu, që ai tjetri nuk ka respekt për ju apo nuk ju pëlqen. Kjo sjellje tregon liri individuale dhe ndershmëri ndaj jush.



©tharakorn, 123rf.de

Ndoshta personi i ftuar ka tashmë një takim ditën që ju e keni ftuar – kjo është një arsye e rëndësishme për Gjermanët. Por mund të ndodhë gjithashtu që ju ti thoni „Jo“ një ftese dhe personi tjetër e pranon përgjigjen tuaj pa ju lutur edhe njëherë nëse do ta pranoni ftesën. Ne ju rekomandojmë të thoni „Jo“ vetëm atëherë, kur e mendoni seriozisht mos shkoni tek personi që ju ka ftuar.



Barazia dhe mënyra e përshëndetjes

Në Gjermani individi shpesh është më i rëndësishëm sesa grupi. Kështu që kulturat e tjera duhet të mësohen fillimisht me këtë fakt. Liria e sejcilit dhe të drejtat e barabarta për të gjithë kanë një vlerë shumë të madhe.

Ashtu si edhe në Bibël jo të gjithë njerëzit janë të barabartë por kanë të njëjtën vlerë, po ashtu të gjithë njerëzit qofshin ata në Gjermani apo në gjithë Evropën janë të barabartë – pavarësisht nëse janë meshkuj, femra, njerëz me ngjyrë apo jo – pavarësisht kujt kulture apo besimi fetar i përkasin. Edhe dashuria për të huajin – kultura jonë e mirëseardhjes – bazohet në faktin, që para Perëndisë të huajit janë po aq me vlerë sa edhe vendasit.

Të drejta të barabarta për mashkullin dhe femrën

Mashkulli dhe femra janë të barabartë përpara ligjit. Kjo gjë nuk ka qënë kryesisht kështu para 50 viteve, madje edhe në ditët e sotme nuk zbatohet akoma gjithandej në mënyrë 100%.

Pjesë e lirisë personale të femrës dhe mashkullit është edhe fakti që mund të vishen ashtu si duan. Nëse disa femra tregojnë pak më shumë lëkurë se të tjerat, atëherë kjo nuk tregon dëshirë seksuale. Madje është e turpshme nëse dikush e sheh për një kohë të gjatë një femër të veshur me pantallona dhe bluzë të shkurtër, që tregon barkun e zhveshur apo që ecën e veshur me një minifund.



©stockbroker, 123rf.de

Gjatë përshëndetjes femrat dhe meshkujt trajtohen në mënyrë të barabartë. Një mashkull përshëndet madje fillimisht femrën për ta respektuar atë. Ndërkohë që përshëndeten, palët shohin njëri-tjetrin shkurtimisht por direkt e në sy. Kjo sjellje nuk është në ansjë mënyrë një shprehje e dëshirës nga mashkulli apo femra për të filluar një marrëdhënie më të thellë.



Përpikmeria dhe takimet

Gjatë muajve të parë në Gjermani mund të ndodhë, që të keni disa takime nëpër institucionet shtetërore në vend. Në rastin e këtyre takimeve është shumë e rëndësishme të keni parasysh përpikmërinë. Duke qënë të përpiktë tregoni vlerësim dhe respekt për tjetrin. Ju rekomandojmë që edhe në rast se do vonoheni 5-10 minuta, ta merrni personin në telefon dhe ta informoni për vonesën. Nëse mbërrini me shumë vonesë, atëherë kjo sjellje është e pahijshme, pasi askush nuk ka dëshirë të presë. Nëse shkoni me vonesë një një intervistë pune, mund të ndodhë që t'ju kthejnë sërish mbrapsh. Në rast se jo, atëherë vonesa juaj do të ndikojë negativisht në gjasat për të fituar vendin e punës. Ju rrezikoni të humbisni mundësitë profesionale duke qënë jo i përpikte, edhe nëse jeni tashmë punonjës i një firme. Vonesat e shpeshta mund të bëhen madje shkak që të pushoheni nga puna.

Përpikmëria veçanërisht e rëndësishme në takimet zyrtare

Kjo gjë vlen jo vetëm për jetën publike, por edhe në rastin e ftësive private duhet ti tregoni mikpritësit respekt duke qënë të përpiktë. Në jetën publike takimet kanë një rëndësi të veçantë. Prandaj mund të ndodhë që bashkëbiseduesi të përfundojë një bisedë me ju pasi ka planifikuar bisedën e radhës me dikë tjetër. Kjo nuk është as një shenjë e të qenit i pasjellshëm apo që personi përballë jush nuk ju pëlqen.



©I-vista, pixelio.de

Këtu bëhet fjalë vetëm që personit që ka takimin pas jush ti jepet e njëjta mundësi që iu dha edhe juve. Për këtë arsye është e rekomandueshme, që kur të paraqisni kërkesa të caktuara ti keni plotësuar paraprakisht dokumentat e kërkuara dhe të filloni direkt e të flisni për arsyen e takimit me qëllim që si ju ashtu edhe personi përballë mund të shfrytëzoni minutat e bisedës për të biseduar pikërisht rreth kërkesës tuaj. Kjo është si në interesin tuaj, po ashtu edhe në interesin e personit përballë jush.



Ndarja e mbeturinave në Gjermani

Në Gjermani ekzistojnë kosha mbeturinash me ngjyra dhe forma nga më të ndryshmet. Ata i gjen në stacione hekurudhore, para shtëpive apo madje edhe nëpër rrugët pyjore që përdoren për ecje. Për Gjermanët është e rëndësishme, që të mos ketë mbeturina në natyrë, në vendet publike, në cepat e rrugëve apo nëpër kopshte.



©Paul-Georg Meister, pixelio.de

Për këtë arsye shteti ndërmerr masa që mbeturinat të hidhen në vendin e duhur dhe që një pjesë e mbeturinave të mund të ripërpunohen. Në këtë mënyrë prodhohen nga letra e vjetër, nga plastika, qelqi apo dhe nga mbeturina të tjera produkte të reja si për shembull letër gazete, vazo lulesh apo shishe. Kështu reduktohet numri i depozitave të mbeturinave, kursehet lënda e parë dhe arrihet, që të digjen më pak mbeturina. E thënë shkurt: Ndarja e mbeturinave dhe riciklimi mbrojnë mjedisin.

Kontenierë të ndryshëm

Në Gjermani mbeturinat mblidhen në kontenierë të ndryshëm. Çdo shtëpi ka koshat e veta të mbeturinave. Në shumicën e rasteve ekzistojnë kosha më vete për letrën – ky lloj koshi e ka kapakun ngjyrë blu. Mbeturinat që vijnë nga paketimet e ndryshme përfundojnë në „qesen e verdhë“ ose në koshin me kapakun e verdhë. Mbeturinat biologjike si ato që mblidhen nga gatimi në kuzhinë ose lulet përfundojnë në të ashtuquajturin kosh bio. Kapaku i këtyre mbeturinave është në shumicën e rasteve ngjyrë kafe ose jeshile.



©Gabi Schoenemann, pixelio.de

Për shumicën e shisheve – qofshin ato prej qelqi ose plastike – njerëzit paguajnë kur i blejnë një të ashtuquajtur Pfand (ose parapagesë), i cili të kthehet mbraps nëse i kthen shishet në dyqan. Shpesh mbledhja e këtyre shisheve ndodh me anë të automateve. Kjo procedurë synon, që njerëzit të shmangin hedhjen e shisheve bosh.

Pjesën e shisheve pa Pfand (parapagesë) njerëzit e mbledhin në shtëpi dhe e hedhin sipas ngjyrave që shishet kanë në kontenierë të posaçëm për qelq me qëllim që këto shishe të mund të ripërdoren. Hedhja e këtyre shisheve shkakton zhurmë, për këtë arsye ato lejohen të hidhen në orare të caktuara.

Pjesa e mbeturinave, për të cilat nuk ekziston ndonjë kontenier special, hidhet në të ashtuquajturin kontenier për pjesën e mbeturinave të mbetura, të cilat shpesh kanë një kapak me ngjyrë të zehtë. Ngjyrat e kontenierëve mund të ndyshojnë nga një zonë në një zonë. Prandaj edhe vetë gjermanëve ju duhet të pyesin për tu siguruar.



Ndarja e mbeturinave kursen para

Nuk është aq e lehtë në fillim të mbash mend se në cilin kontenier duhen hedhur mbeturinat. Por kush i ndan mbeturinat në Gjermani dhe në këtë mënyrë mbron mjedisin, ndaj atij tregohet respekt. Ne nga Deutschland-Begleiter.de ju rekomandojmë që të informoheni rreth hedhjes së mbeturinave në zonën tuaj.

Infomacione lidhur me hedhjen e mbeturinave mund të gjeni në zyrën përkatëse për menaxhimin e mbeturinave në zonën ku jetoni. Ose pse jo, të flisni me ndonjë komshi ose me ndonjë punonjës nga Deutschland-Begleiter.de

Ndarja e mbeturinave ka edhe ndikim financiar. Në disa zona mbeturinat e mbetura peshohen. Sa më të rënda të jenë mbeturinat, aq më shumë kushton hedhja e tyre. Mbeturinat e letrës dhe paketimeve transportohen falas, ndryshe nga mbeturinat e tjera.

Përgjegjësi për tokën

Kultura e ndarjes së mbeturinave në Gjermani ka të bëjë pak edhe me rrënjët e krishtera të Gjermanisë. Të krishterët e kanë për detyrë të ruajnë tokën, pasi ajo është një dhuratë e Perëndisë. Kjo deytërë ka lënë gjurmë të thella në shoqërinë tonë.

Edhe pse në ditët e sotme shumë njerëz e mbrojnë mjedisin, pa u bazuar tek Perëndia apo tek Bibla, kjo sjellje i ka gjithsesi rrënjët tek përgjegjësia përpara Perëndisë. Kështu Bibla na thotë tek Zanafilla 2,15 dhe në Psalim 115, 16, që Toka i përket Perëndisë dhe ne njerëzit duhet të kujdesemi për të, ta vlerësojmë dhe ta mbajmë siç duhet. Ne njerëzit e kemi për detyrë ta japim brez pas brezi këtë të mirë, që kemi marrë nga Perëndia.



©helenesouza.com, pixelio.de

Ekzistojnë edhe faqe të tjera interneti, të cilat shpjegojnë në gjuhë të ndryshme, se cilat mbeturina duhen hedhur në kontenierët përkatës.

www.abfallwirtschaft-heidenheim.de/internet/inhalt/inhalt.php?seite=184

www.mettmann.de/abfallberatung/infoshop.php



Kujdesi ndaj resurseve

Ujë, energji, karburant, lëndë e parë, ushqime, ngrohje

Ndoshta ju ka rënë në sy: Gjermanët investojnë shumë kohë dhe para për mbrojtjen e mjedisit. Një gjë e tillë ka zënë rrënjë të thella në jetën e përditshme dhe është bërë pjesë e Gjermanisë. Për këtë arsye për ne nga Deutschland-Begleiter.de është e rëndësishme, që të tematizojmë disa çështje themelore.

Resurset janë para së gjithash lëndë e parë si qymyri, gazi, uji apo edhe minerale të tjera. Resurset nuk na qëndrojnë pa mbarim në dispozicion, pra ato edhe mund të harxhohen një ditë. Përveç kësaj ne mund të kursejmë shumë para, nëse dimë si ti përdorim resurset.

Njerëzit, të cilët i përdorin me kujdes resurset, mendojnë për të ardhmen e fëmijëve të tyre si dhe për fëmijët e fëmijëve, me qëllim që ata të gjejnë një planet në të cilin ia vlen të jetosh. Kjo sjellje ka të bëjë me rrënjët e krishtera në Gjermani dhe Europë. Perëndia na e ka besuar tokën, ndaj ne duhet të tregojmë përgjegjësi të plotë për të.

Përveç kësaj Bibla na thotë, që ne duhet të ndajmë me njerëzit që kanë më pak. Çdo njeri mund të ndajë me të tjerët vetëm nëse sillet me kujdes dhe me përgjegjësi me pronësinë e vet. Prandaj ne ju sugjerojmë, që të kujdeseni për resurset kudo ku është e mundur. Kush e bën një gjë të tillë në Gjermani, respektohet nga të tjerët.



Të kursesh resurset – Energji dhe Ngruhje

Shumë nga idetë për të kursyer energjinë janë të thjeshta dhe me shumë gjasa ju i zbatoni shumë nga ato në jetën tuaj të përditshme: Për shembull rekomandohet, që ta fikim dritën, nëse nuk na duhet.

Na nevojitet më pak energji, nëse përdorim një ujëngrohës në vend që ta ngrohim ujin mbi sobë. Nëse gatvani, atëherë përdorni pjesën e sobës që i përshtatet madhësisë së tenxheres suaj dhe është mirë të gatvani me kapak, me qëllim që të mos harxhohet më kot shumë energji.

Shumicën e sobave mund ti fikim të paktën tre minuta para se mbarojë procesi i gatimit dhe të përdorim në këtë mënyrë pjesën e mbetur të nxehtësisë mbi sobë. Hiqni karikuesin nga priza, nëse nuk e karikoni telefonin etj. Edhe kur shikoni televizor është mirë, që ta fikni atë komplet natën, pasi ai harxhon energji nëse e lini në modusin Standby.



©Bacho Foto, fotolia.de



Ne ju rekomandojmë, që të tregoheni kursimtarë me ngrohjen. Sigurisht që nuk duhet të ngrini nga të ftohtët, por të ndiheni rehat në shtëpi apo në dhomë. Por ndonjëherë është më e dobishme që të veshim një pulovër të ngrohtë në shtëpi dhe të veshim pantofla në vend që të gradojmë ngrohjen edhe më shumë.

Informohuni lidhur me funksionimin e ngrohjes. Disa lloj aparatesh e rregullojnë për shembull vetë temperaturën e ngrohjes. Është mirë të reduktoni temperaturën, nëse dilni për disa orë nga shtëpia.



Me qëllim që ajri të mos rëndohet apo të mos krijohet lagështirë, është mirë të ajrosni dhomat herë pas here. Nuk është mirë, nëse e mbajmë dritaren hapur pa pushim. Shumë më mirë do ishte nëse e hapim dhe e mbyllim dritaren disa herë në ditë për pak minuta sa për ajrosje dhe më pas ta mbyllim sërish. Kur të ajrosni, fiken ngrohjen dhe pas ajrosjes mund ta ndizni ngrohjen sërish.

Të kursejmë resurset – Uji dhe Kemikalet

Nëse është e mundur, lajini rrobat vetëm atëherë kur lavatriçja të jetë e mbushur plot. E njëjta gjë vlen edhe për lavastoviljen. Shmangni përdorimin e ujit të rrjedhshëm. Enët mund të lahen shumë mirë edhe në një enë apo lavaman të mbushur me ujë. Mos e lini ujin të rrjedhë pa pushim kur lani dhëmbët apo kur bëni dush. Edhe ilaçin larës qoftë për enët, rrobat apo për pastrim si dhe shampot mundohuni ti përdorni me kursim. Në këtë mënyrë mund të kujdesemi për mjedisin dhe të kursejmë para.



©Oleg Doroshin, fotolia.de

Ushqimet dhe udhëzime të tjera

Edhe ushqimet janë resurse, që nuk na qëndojnë pa mbarim në dispozicion. Edhe me ushqimet ju nuk duhet të kufizoheni – në Gjermani gjithkush ka mjaftueshëm për të ngrënë dhe për këtë ne jemi mirënjohës. Por blini aq shumë ushqime sa keni nevojë. Supermarketi ofron edhe javën që vjen ushqime, që nevojiten për të jetuar. Dhe përpiquni që të mos i hidhni ushqimet.

Nëse dëshironi më shumë informacione lidhur temën e resurseve, atëherë mund të pyesni tek zyra për konsumatorin ose mund ti drejtoheni personit që ju ka kontaktuar nga Deutschland-Begleiter.de ose mund të kërkonit një iniciativë apo një bashki në afërsinë tuaj.



Familja si themel i bashkëjetesës

Kudo ku njerëzit bashkëjetojnë me njëri-tjetrin, ekzistojnë familje. Familja është themeli më i rëndësishëm i shoqërisë në të gjitha kulturat. Në një familje njerëzit mbështesin njëri-tjetrin. Prindërit kujdesen për fëmijët, motrat dhe vëllezërit rriten së bashku dhe përveç tyre ka edhe të afërmit të tjerë si gjyshja me gjyshin, xhaxhai, dajua, halloja dhe tezja, kushërinj dhe kushërira.

Familja në Gjermani

Fjala 'familje' në Gjermani nënkupton para së gjithash familjen e përbërë në thelb nga babai, nëna dhe fëmijët. Edhe pse ekziston një marrëdhënie e mirë me gjyshin dhe gjyshen, ata nuk jetojnë zakonisht në të njëjtën shtëpi me fëmijët e tyre. Marrëdhëniet me të afërmit e tjetër janë herë të ngushta e herë jo, kjo marrëdhënie ndryshon nga një familje në një familje. Trendi i të paturit një familje të vogël në Gjermani ka pësuar rritje duke filluar nga shekulli i 19-të me zhvillimin apo nën ndikimin e industrializimit. Sa vjen e më shumë familje jetojnë në hyrje të vogla në qytete dhe janë të pavarur ekonomikisht nga të afërmit e tyre.



Familja në Gjermani mbrohet në mënyrë të veçantë nga neni 6 i kushtetutës. Ky status i veçantë që gëzon familja, i cili tregon edhe një vlerësim të madh, i ka rrënjët e veta në pikëpamjen biblike për martesën dhe familjen. Martesa sipas kuptimit biblik është një besëlidhje midis burrit dhe gruas. 'Shpikësi' i martesës është vetë Perëndia.

Familjet ndryshojnë

Përveç familjes tradicionale, e cila përbëhet nga babi, nëna dhe fëmijët, familja në Gjermani po përkufizohet gjithmonë e më shumë si një bashkësi jetese, ku breza të ndryshëm marrin përgjegjësi për njëri-tjetrin. Këto mund të jenë të ashtuquajturat 'familje patchwork' (familje të përziera), çifte të ndarë, që i edukojnë dhe rrisin fëmijët vetë ose çifte të së njëjtës gjini, që sjellin fëmijë me vete nga marrëdhënie të mëparëshme. Familje patchwork do të thotë që familja përbëhet nga fëmijë të ndryshëm, të cilët partnerët apo prindërit i kanë sjellë me vete nga lidhjet apo martesat e tyre të mëparëshme. Këto lloj marrëdhënies njihen zyrtarisht nga shteti gjerman.

Shumë nga këto forma moderne të familjes të cituara më sipër nuk përputhen me atë çfarë thotë Bibla se si njerëzit duhet të jetojnë me njëri-tjetrin. Edhe pse ndoshta disa nga këto forma të familjes mund të duken të pazakonshme dhe jo të mira, e rëndësishme është, që të tregohet respekt ndaj njerëzve, që kanë një bindje tjetër. Kjo është pjesë e lirisë, që ofron demokracia në Gjermani.



Sfidat e familjes

Edhe pse shumica e njerëzve në Gjermani synojnë një martesë dhe familje të lumtur, nuk është e vetëkuptueshme, që kjo i ndodh çdo familje. Fatkeqësisht shumë martesë dështojnë. Të tjerë jetojnë pa u martuar. Shpeshherë në Gjermani flitet për të ashtuquajturit 'parterë për një pjesë të jetës', domethënë për një marrëdhënie të përkohshme. Pasojat e mungesës së një marrëdhënie të shëndoshë janë fëmijët, të cilët vuajnë nga ndarja e prindërve si dhe nënat dhe baballarët, të cilët duhet ti rrisin vetë fëmijët e tyre me shumë vështirësi.

Familja duhet të jetë një vend që të fal siguri. Për këtë nevojitet respekti i ndërsjellë dhe marrja parasysh e nevojave të të tjerëve. Në rast të kundërt lindin konflikte, të cilat e rrezikojnë familjen. Nëse këto konflikte çojnë në dhunë, atëherë në Gjermani ndërhyjnë shteti. Si në çift ashtu edhe në familje përdorimi i dhunës është i ndaluar dhe dënohet me ligj. Sipas rrethanave të ndryshme janë miqtë dhe komshinjtë ata që informojnë institucionet përkatëse në rast se vërejnë dhunë.



©Wavebreak Media, 123rf.de

Si jeton një familje në Gjermani?

Shumica e njerëzve në Gjermani jetojnë në familje të vogël ose si beqarë. Të pasurit e një shtëpie është ëndrra e shumë gjermanëve. Në zonat rurale është zakon, që breza të ndryshme të jetojnë së bashku nën një çati.

Në shumicën e familjeve punojnë të dy partnerët. Duke punuar të dy rriten të ardhurat dhe në këtë mënyrë edhe mirëqënia. Nga ana tjetër shumë familje kanë nevojë për një rrogë të dytë me qëllim që të mbulojnë shpenzimet. Në Gjermani është zakon dhe madje parashikuar në ligj që burri të ndihmojë në punët e shtëpisë, p.sh. të lajë enët, të fshijë, të hedhë mbeturinat dhe punë të tjera.



©Volodymyr Vorona, 123rf.de

Partnerët kanë zakonisht një marrëdhënie të ngushtë dhe të bazuar në besim reciprok. Ata i gjenden njëri-tjetrit pranë për çdo çështje dhe janë personat më të rëndësishëm të kontaktit. Me fjalë të tjera partneri është më i rëndësishëm se motra, vëllai apo edhe prindërit. Themeli ku bazohet kjo pikëpamje është Bibla. Ajo thotë, që burri duhet të braktisë babanë dhe nënën e vet dhe të bëhet Një me gruan e vet. Kështu lind një familje e re, e cila nuk varet nga prindërit e të dy partnerëve. Gjithësesi prindërit duhet të nderohen dhe respektohen.



Jetëgjatësia e njerëzve në Gjermani është rritur në vitet e fundit. Duke qënë se njerëzit jetojnë më gjatë, ata kanë nevojë për shërbim shëndetësor. Shumë fëmijë apo edhe të afërm marrin përsipër të kujdesen për prindërit e tyre në shtëpi. Të tjerë të moshuar marrin përkujdesje në azil pleqsh ose qëndra përkujdesje.

Kjo është një alternativë e rëndësishme, nëse njerëzit e afërm nuk janë aty ose nëse përkujdesja në shtëpi nuk është e mundur. Nga pikëpamja e kushtetutës si dhe ajo biblike prindërit kanë përgjegjësi për fëmijët dhe fëmijët për prindërit. Sipas rrethanave të jetës të dyja palët mundohen të marrin përgjegjësi për njëri-tjetrin.

Si i edukojnë njerëzit fëmijët në Gjermani?

Një dëshirë e madhe e prindërve gjermanë është, që fëmijët e tyre të edukohen në mënyrë të pavarur. Si vajzat ashtu edhe djemtë gezojnë të njëjtën vlerë në Gjermani. Për vajzat dhe djemtë ekzistojnë mundësira nga më të mirat për arsimim dhe të dyja gjinitë gëzojnë të njëjtat të drejta dhe të njëjtat mundësi.

Prindërit i trajtojnë fëmijët e tyre me dashuri dhe respekt. Në Gjermani është e ndaluar me ligj që ti ndëshkosh fëmijët duke ushtruar dhunë fizike apo mendore.

Prindërit i përkrahin fëmijët e tyre në shkollë duke i ndihmuar për shembull me detyrat e shtëpisë. Ata gjithashtu iu mundësojnë fëmijëve aktivitete shtesë duke i regjistruar në shoqata sportive apo muzikore ose në bashkësi të krishtera. Aty fëmijët jo vetëm që zhvillojnë më tej aftësitë e tyre në fusha të caktuara por në të njëjtën kohë zgjerojnë kompetencat e tyre sociale duke kaluar kohë me bashkëmoshatarë të tjerë, duke luajtur dhe u zbavitur me ta. Të gjitha këto shoqata apo bashkësi janë të hapur të pranojnë fëmijë që vijnë edhe nga vende të tjera, pavarësisht përkatësisë së tyre fetare.





Krishtlindjet

Festa e Krishtlindjeve është shumë e rëndësishme për Gjermanët, madje për shumë nga ata kjo është periudha më e rëndësishme e vitit. Po aq të larta janë edhe kërkesat dhe pritshmëritë lidhur me këtë festë.

Me Krishtlindjet ndërthuren edhe shumë zakone e tradita. Kështu për shembull duke filluar që në vjeshtë në shumë dyqane mund të gjenden embëlsira të veçanta për kohën e krishtlindjeve si Lebkuchen, Plätzchen (biskota) dhe Stollen (keku i krishtlindjes). Në shumë vende hapen të ashtuquajturit tregjet e krishtlindjeve. Në shumë shtëpi vendosen ndriçime të veçanta si dhe pema e Krishtlindjes. Njerëzit takohen në shoqata, me kolegët dhe miqtë për të festuar Krishtlindjet.



Dhurata dhe atmosferë perfekte

Festa e Krishtlindjes na kujton me traditën e saj të krishterë, që Perëndia iu është drejtuar njerëzve me anë të Jezusit në një menyre krejt të veçantë. Gjatë periudhës së Krishtlindjeve të krishterët festojnë lindjen e Jezusit, kohë nga e cila fillon numërimi i viteve. Jezusi është për të krishterët dhurata më e madhe e Perëndisë për botën. Prandaj edhe dhuratat janë një pjesë e rëndësishme e kësaj feste. Ata njerëz, që nuk janë më aq të vetëdijshëm për rrënjët e krishtera të Krishtlindjes apo për të cilët kjo festë nuk ka aq shumë rëndësi, e shohin shpesh festën e Krishtlindjes si një festë të dashurisë, të familjes dhe të paqes. Por edhe këtu pasqyrohen rrënjët e krishtera: Perëndia na fal ne me anë të Jezusit dashurinë dhe paqen e Tij.

Shërbesa dhe historia e krishtlindjes

Në Mbrëmjen e Shenjtë, në datën 24 dhjetor shumë njerëz shkojnë në shërbesë. Edhe ata njerëz që nuk kanë vetë besim të thellë shkojnë tradicionalisht në kishë për Krishtlindje. Këto shërbesa janë publike dhe gjithkush mund të shkojë – edhe miq nga kultura dhe besime të tjera fetare janë të mirëpritur. Në shumë shërbesa në mbrëmjen e shenjtë fëmijët luajnë historinë e Krishtlindjes. Prindërit e Jezusit duhet të udhëtojnë gjatë për shkak të regjistrimit të popullsisë dhe gjejnë një grazhd si vend për të kaluar natën. Aty u lind Jezusi mes kushteve më të thjeshta. Barinjët ishin njerëzit e parë, të cilët morën vesh nga engjëjt e Perëndisë për lindjen e shpëtimtarit. Më vonë një yll udhëhoqi një grup me burra të zgjuar aty ku ndodhej Jezusi – biri i Marias.



©Karl-Heinz Laube, pixelio.de

Kjo histori është ilustruar në figura – të ashtuquajturat figura të hambarit të Krishtlindjes, figura që gjenden në shumë kisha dhe shpesh nëpër shtëpi. Shërbesat e krishtlindjes rrezatojnë zakonisht një atmosferë të veçantë festive me anë të këngëve dhe teksteve dedikuar kësaj feste apo nëpërmjet ndriçimit enkas për festën e Krishtlindjes.



Një kohë e veçantë

la vlen të vizitosh një shërbesë të tillë krishtlindjesh për të përjetuar ndjesinë e krishtlindjes. Në përfundim të shërbesës njerëzit largohen për në shtëpitë e tyre pa kryer biseda të gjata pasi dëshirojnë të festojnë me familjet e tyre. Kjo është një sjellje zakonisht dhe nuk duhet parë në asnjë mënyrë si një veprim jo i sjellshëm.

Në shtëpitë ka dhurata, të cilat për shumë njerëz kanë një vlerë tepër të veçantë: Gjatë javëve para Krishtlindjes – e ashtuquajtura koha e Adventit – shumë njerëz zbavitën duke blerë dhurata. Gjatë kësaj kohe shumë njerëz bëhen më sentimentale se zakonisht. Zbavitja nuk është faktikisht kuptimi fillestar i Krishtlindjes, por është mirë të mirëkuptohet.



©Achim Reicher, pixelio.de

Gjatë ditëve të Krishtlindjeve, dmth. më 25 dhe 26 dhjetor në Gjermani mbizotëron qetësia. Pothuajse të gjithë dyqanet janë të mbyllur, njerëzit rehatohen nëpër familjet e tyre. Krishtlindja festohet zakonisht me rrethin e ngushtë familjar – ndonjëherë kryen vizita tek prindërit apo tek vjehrra dhe vjehri.

Prandaj nuk konsiderohet si një sjellje jo e hijshme ose e çuditshme, nëse dikush nuk të fton në një festë të tillë familjare. Festimi me rrethin e vogël familjar ka të bëjë thjesht me kulturën. Krishtlindja është një festë e krishterë dhe është e rrënjosur thellë në shoqërinë tonë. Nuk duhet ngatërruar me festën e Vitit të Ri, që festohet më 31 dhjetor, pra pak ditë pas festës së Krishtlindjes dhe që shënon kalimin në vitin e ri duke u festuar shpesh me fishekzjarre të zhurmshëm.

Ne urojmë, që gjatë kohës së Krishtlindjes ju të krijoni një përshtypje për domethënien e Krishtlindjes dhe që edhe ju të mund të festoni ndopak këtë festë bashkë me ne.

Ju urojmë Gezuar Krishtlindjet dhe bekime!



Pashka – një ndër festat më të rëndësishme në vit

Në muajin shkurt fillon nëpër dyqanet gjermane periudha e vezëve dhe lepujve prej çokollate. Këto janë shenja të festës së pashkës, festë e cila i ka rrenjët e thella në kulturën perëndimore. Kjo festë nuk festohet në një date fikse, por ndryshon nga viti në vit. E diela e pashkës përkon gjithmonë me hënën e plotë pranverore – që në shumicën e rasteve është në fund të marsit ose në fillim të prillit.



Për të krishterët ditët nga e premtja e zezë dmth. e premtja para pashkës, deri tek e hëna e pashkës janë ndër ditët festive më të rëndësishme të vitit. Në Gjermani e premtja e zezë dhe pashkët deri tek e hëna e pashkës janë ditë festive me ligj. Gjatë këtyre ditëve dyqanet qëndrojnë mbyllur. Vezët dhe lepujt simbolizojnë një jetë të re dhe ringjalljen. Edhe natyra fillon e zgjohet, pranvera fillon në këtë kohë – një periudhë ideale për të festuar festën e ringjalljes.

Traditat në Gjermani

Shumë prej zakoneve të pashkës na kujtojnë rrënjët e krishtera, megjithëse për shumë njerëz këto zakone e kanë humbur rëndësinë e tyre të krishterë. Kështu shtatë javë përpara pashkës të krishterët kalojnë një kohë argjërimi, e cila i përgatit ata tradicionalisht për ardhjen e pashkës. Disa nga të krishterët heqin dorë plotësisht nga ushqimi, nga ushqime të veçanta ose nga gjëra të tjera për tu përqëndruar tërësisht tek ai që është më i rëndësishmi – pra tek Jezusi. Edhe pse dyqanet në kohën e pashkës janë të mbushur me embëlsira, shumë prej njerëzve heqin dorë prej tyre gjatë argjëritimit.

E enjtja e madhe dhe e premtja e zezë

Ditën e enjtë para pashkës, dmth. të enjten e madhe dhe të shenjtë, të krishterët kujtojnë darkën e fundit që Jezusi kaloi me dishepujt e vet. Për këtë histori na tregon Dhjata e Re në Bibël. Gjatë kësaj darke të fundit Jezusi flet për vuajtjet që do vijnë dhe ndan bukën e verën, me qëllim që dishepujt e Tij dhe më vonë të gjithë të krishterët ta kujtojnë atë dhe të kalojnë bashkësi me të. Në të njëjtën mbrëmje Jezusi u arrestua.



©Antonio Gravante, istock.com

Jezusi u mor në pyetje, u torturua dhe më në fund u dënua me vdekje. Të krishterët kujtojnë ditën e së premtes së zezë ekzekutimin e dënimit me vdekje si dhe kryqëzimin mizor të Jezusit. Faji dhe mëkatet e ndajnë njeriun nga Perëndia. Këtë gjë na e mëson Bibla, Fjala e Perëndisë. Perëndia është i mirë, i shenjtë dhe i përsosur. Prandaj askush nuk mund të krahasohet me të, pasi çdo njëri prej nesh ka mëkatuar.



©joshblade, istock.com

Dhe mëkati të çon në vdekje dhe në një ndarje të përjetshme nga Perëndia. Njerëzit nuk mund të ndryshojnë asgjë me forcën e tyre. Madje dhe historia e djalit të Abrahamit vë në dukje ardhjen e shpëtimtarit. Kur djali i Abrahamit duhet të vdiste, Perëndia dërgoi një flijim, që u ther në vend të tij, kështu që djali i tij të mund të jetonte.



Bibla na bën të qartë, që gjaku që rrjedh nga kafshët nuk mund të na mbrojë nga gjyqi dhe ndëshkimi i Perëndisë. Për këtë nevojitet një flijim i pastër dhe i përsosur. Qënia e vetme pa mëkat dhe e pastër është vetë Perëndia. Kështu që vetë Perëndia mund të na heqë mëkatet tona dhe të na shpëtojë ne njerëzve. Bibla e përmend në shumë vende ardhjen e shpëtimtarit.

Ky shpëtimtar – Mesia – është më shumë se veç një njeri. Perëndia vjen vetë në botë duke na u shfaqur në qënien e Mesias. Profeti Isaia parashikon 750 vite para Krishtit, që Mesia do të sakrifkohet për fajet tona si një qengj flijues. Kur profeti Gjon Pagëzori e pa Jezusin për herë të parë, ai tha: Ky është qingji flijues i Perëndisë, i cili do të marrë mbi kryq mëkatet e botës.

Jezusi na liron rrugën për tek Perëndia

Kështu Jezusi ka marrë fajin e besimtarëve me anë të vdekjes së Tij dhe na ka bërë rrugën e lirë për tek Perëndia, Ati, me anë të ringjalljes së Tij. Në Dhjatën e Re na thuhet, perdjia e tempullit u gris me vdekjen e Jezusit. Kjo është një shenjë, që na tregon, se njeriu mund të jetojë vetëm me anë të Jezus Krishtit në një marrëdhënie të ngushtë me Perëndinë. Ne njerëzit jemi plotësisht të shpëtuar me anë të Jezusit dhe do të jemi përjetësisht pranë Perëndisë.



©Kevin Carden,123rf.de

Ndodhitë e të premtës së zezë nuk janë një rastësi dhe aspak fitore e së Keqes. Perëndia e kishte planifikuar këtë me kohë, siç për shembull mund të lexojmë në psalmin 22 të profetit David, tek profeti Isaia në kapitullin 53 apo në ungjillin e Gjonit në kapitullin 10.

Ju ndoshta mund të keni degjuar, që është kryqëzuar Juda dhe jo Jezusi. Kjo nuk mund të vërtetohet në asnjë burim historik dhe bie në kundërshtim me thëniet e Jezusit, i cili e kishte përmenduar disa herë vdekjen e Tij.

Nëse keni dëgjuar se të krishterët i luten kryqit, kjo nuk është e saktë. Të krishterët i luten vetëm Perëndisë.

E diela e pashkës – ringjallja e mishëruar

Te dielën e pashkës të krishterët kujtojnë në veçanti ringjalljen e Jezusit nga vdekja. Të krishterët besojnë, se Jezusi nuk qëndroi i vdekur, por Ai e mundi vdekjen, ashtu siç e kishte shpallur shumë herë më parë. Një shembull për këtë qëndron tek ungjilli sipas Mateusit në kapitullin 12, ku Jezusi e krahason vdekjen dhe ringjalljen e vet me Jonasin, i cili qëndroi tre ditë në barkun e një peshku.



©Glenda Powers, fotolia.de

Disa njerëz dyshojnë në vërtetësinë e vdekjes dhe ringjalljes së Jezusit. Shumë profetë e kanë shpallur në Shkrimin e Shenjtë ardhjen, vuajtjen, vdekjen dhe ringjalljen e Mesias. Këto profecira janë përmbushur në jetën e Jezusit.



Edhe përtej Biblës ekzistojnë të dhëna lidhur me këto ndodhi, si për shembull në raportimet e historisë romake. Vdekja dhe ringjallja e Jezusit janë fakte të sigurta historike. Shkencëtari Josh MacDowell donte të vërtetonte se Krishtërimi nuk ekziston, por gjatë kërkimeve të veta ai u bë vetë i krishterë dhe i ka shkruajtur rezultatet e kërkimeve të veta në librin „Fakti i ringjalljes“.

Vetë personat e fuqishëm në atë kohë kishin frikë, se Jezusi do të ringjallej. Prandaj ata e vulosën zyrtarisht varrin dhe e ruanin. Meqënëse ata nuk mund ta tregonin më trupin e Krishtit, kjo tregon, se Jezusi është ringjallur me trup. Nëse nuk do të ishte kështu, atëherë besimi në të do ishte i kotë.

Jezusi u pa nga shumë njerëz pas ringjalljes së Tij dhe ai ka ngrënë për shembull peshk. Tomasi, njëri nga 12 dishepujt nuk e besonte që Jezusi ishte ringjallur. Por kur ai e pa Jezusin dhe kur preku plagët e tij, e besoi ringjalljen e Tij.

Të krishterët në mbarë botën janë të sigurt për ringjalljen trupore të Krishtit dhe këtë gezim ata e tregojnë edhe me një përshëndetje që ia thonë dhe i përgjigjen njëri-tjetrit ditën e të dielës së pashkës: “Krishti u ngjall” – “Vërtet u ngjall”.

Informacione të tjera

Nëse dëshironi të dini më shumë rreth pashkës, atëherë mund të vizitoni për shembull një nga kopshtet e pashkës në afërsinë tuaj (www.sinnenpark.de/html/veranst/termine2012.html). Aty tregohet historia e Jezusit duke filluar nga e enjtja e madhe deri të dielën e pashkës. Dhe sigurisht që mund të vizitoni një shërbesë në afërsinë tuaj ditën e të dielës së pashkës.



Shumë bashkësi organizojnë shëtitje për pashkë dhe hanë së bashku mëngjez. Edhe jo të krishterë janë të mirëpritur të marrin pjesë si miq në të gjitha këto aktivitete. Ne ju ftojmë pse jo të vizitoni një shërbesë të tillë – ndoshta me personin, i cili ju ka tërhequr vemendjen tek Deutschland-Begleiter.de.

Tek faqja e kontaktit në Deutschland-Begleiter.de mund të gjeni njerëz në afërsinë tuaj, të cilët mund t'ju ndihmojnë të kuptoni besimin e krishterë.

Edhe diçka: Nëse për pashkë shikoni fëmijë që kërkojnë ëmbëlsira në kopshtin e shtëpisë apo në banesë, edhe kjo traditë është pjesë e pashkës. Fshehja dhe kërkimi i ëmbëlsirave dhe dhuratave të vogla është thjesht një traditë e bukur, të cilën gjermanët e ruajnë për pashkë.





Ngritja e Jezusit në Qiell – Jezusi u pranua në Qiell

Dyzet ditë pas pashkëve festohet një tjetër festë, ku të krishterët festojnë ngritjen e Jezusit në qiell. Kjo festë na kujton, që Jezusi nuk qëndroi në tokë pas ringjalljes së tij fizike. Ai u kthye përpara syve të miqëve të tij sërish tek Ati – pra në Qiell. Lukasi e përshkruan këtë moment në kapitullin 24 të ungjillit të tij.

„Jezusi i priu dishepujt e Tij jashtë deri në Betani dhe, si i ngriti duart lart, i bekoi. Dhe ndodhi që, ndërsa ai po i bekonte, u nda prej tyre dhe e morën lart në qiell. Dhe ata pasi e adhuruan, u kthyen në Jeruzalem me gëzim të madh.“



©Kathrin Brechbühler, pixelio.de

Që prej asaj kohe, Jezusi nuk është shfaqur më mes njerëzve. Ai ndodhet pranë Perëndisë, Atit në Qiell. Dhe prej atje Ai do të shfaqet në tokë kur të vijë koha duke u kthyer sërish. Që prej ngritjes në Qiell, njerëzit mund të flasin me të me anë të lutjes.

Por Ai nuk i lë vetëm miqtë e Tij në tokë. Ai u dërgon atyre Frymën e Shenjtë. Me anë të Frymës së Shenjtë Ai i qëndron secilit prej besimtarëve shumë afër. Të Krishterët e festojnë ardhjen e Frymës së Shenjtë në Ditën e Rrëshajave.

Ngritja në Qiell: Një festë e harruar

Shumë njerëz nuk dinë më kuptimin e festës së ngritjes së Jezusit në Qiell. Edhe pse kjo ditë është një ditë feste zyrtare, njerëzit e kanë kthyer këtë ditë në ditën e „baballarëve“, kur burrat organizojnë ekskursione duke konsumuar shpesh shumë alkool së bashku.



Në kohët e mëparshme ekzistonin edhe tradita të ndryshme sidomos mes fshatarëve. Në këtë ditë njerëzit luteshin për një korrje të suksesshme dhe si ushqim njerëzit hanin në këtë ditë feste para së gjithash „mish zogjsh“, për shembull pëllumba të mbushur. Edhe bukët e pjekura në formë zogjsh të kujtonin që kjo ditë ishte një ditë ndryshe nga ditët e tjera.

Në ditën e ngritjes së Jezusit në Qiell të krishterët festojnë shërbesa, disa prej tyre organizohen madje në ambiente të hapura në ajër të pastër. Edhe në këto shërbesa vizitorët janë të mirëpritur të marrin pjesë – qofshin të krishterë ose jo.